

## **Fjala e Ministrit**

Jam i lumtur që së bashku me partnerin tonë të rëndësishëm USAID, të marr pjesë sot në mbledhjen e parë të ndërmjetësve të licencuar në Shqipëri dhe fillimit të procedurave për krijimin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit.

Sot është një ditë e shënuar sepse jemi dëshmitarë për fillimin e një momenti të rëndësishëm në fushën e drejtësisë, jemi dëshmitarë edhe të një hapi po aq të rëndësishëm në reformën e drejtësisë në Shqipëri. Nga sot starton punën një ekip i ri profesionistësh, të cilët do të ndihmojnë qytetarët të zgjidhin mosmarrëveshjet në rrugë jashtë gjyqësore.

Një vit më parë, u premtuam qytetarëve se do të fillojmë reforma dinamike të sistemit të drejtësisë. Bashkë me USAID-in, premtuam se sistemi gjyqësor do të jetë më transparent dhe do të digitalizojmë çdo fjalë e çdo germë që thuhet në gjykata, që qytetarët të dëgjonin e shihnin qartë, si bëhej drejtësia për ta. Pak muaj më parë bashkë me Jai-in filluam dhe po ecim në çdo gjykatë.

Mbajtëm fjalën para qytetarëve.

Kemi folur një vit më parë, se përgjatë rrugës së reformës në drejtësi do të ndërtonim edhe një pjesë tjetër të mozaikut të kësaj reforme: Do të ndërtonim një ekip të ri të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore. Krijua gjatë kësaj kohe kuadrin ligjor të nevojshëm dhe sot jemi në momente krenarie për stafin e Ministrisë së Drejtësisë dhe partnerin tonë USAID sepse nuk flasim më në të ardhmen, mbajtëm premtimin dhe kjo reformë është bërë realitet.

Sot së bashku me partnerin tonë të rëndësishëm në fushën e reformave në drejtësi USAID-in, po implementojmë dhe po nxjerrim në praktikë operatorët e parë të këtij instituti aq shumë të domosdoshëm për qytetarin shqiptar.

Nëse shohim stastikat gjyqësore jo rrallë ne vërejmë se shpesh gjykatat janë të mbingarkuara nga çështjet gjyqësore, e për këtë shkak gjyqtarët seancat i programojnë larg nga njëra-tjetra, e qytetarët ndihen të pakënaqur nga ky shërbim publik i rëndësishëm për ta. Ndaj dhe reforma e rëndësishme e alternativës së re të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, më pak shpenzime, më pak kohë, më me pak burokraci e më shumë besim, do të krijojë një klimë të re në marrëdhëniet mes qytetarëve dhe zgjidhjes së konflikteve.

Kjo është reformë e rëndësishme, e cila vjen në Shqipëri pas suksesit që ka patur në vendet më të zhvilluara dhe me drejtësi më të konsoliduar se kjo e jona. Ne jemi të bindur se kjo reformë e munguar deri më sot në Shqipëri, jo vetëm që do ta modernizojë sistemin e drejtësisë, por përbën

padryshim një hap cilësor drejt reformës në drejtësi, sepse ajo do të lehtësojë trupën gjyqësore nga shumë e shumë çështje duke e bërë më efikase dhe më profesionale.

Ne sot po shënojmë një prej arritjeve të rëndësishme në inaugurimin e reformimeve tona të përbashkëta për një sistem gjyqësor transparent dhe me efikasitet të lartë në cilësi, ku do të jenë vetë qytetarët që me vullnetin e tyre të lirë të zgjidhin në një kohë të shpejt dhe me një kosto efektive të ulët mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.

Instituti i ndërmjetësimit i krijuar prej 13 vjetësh (në vitin 1999) nuk ka patur një traditë të konsoliduar, që të garantonte profesionalizmin dhe efektivitetin e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve jashtë dyerve të gjykatave. Sot palët kanë një mundësi tjetër, një mundësi të artë që tërësisht në vullnetin e tyre të lirë të zgjedhin një prej jush, për t'i dhënë fund konfliktit ndërmjet tyre, duke eliminuar një herë e përgjithmonë kalvarin e gjatë të endjes nga një seancë gjyqësore në seancën tjetër, nga një derë e gjykatës në derën tjetër, nga një shpenzim në një shpenzim tjetër akoma dhe më të madh për xhepat e tyre.

Nga sot ne i japim qytetarëve, alternativën e re të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Alternativën e ndërmjetësimit jashtëgjyqësor, me një ekip profesionistësh. Një juri jashtëzakonisht profesionale, Komisioni i Licensimit, i përbërë me ekspertët më të mirë shqiptarë, ish anëtarë të Gjykatës së Lartë, dekanë fakultetesh, përfaqësues nga organizmat ndërkombëtare, profesorë të së drejtës, kanë drejtuar një reformë të rëndësishme pranë Ministrisë së Drejtësisë duke çertifikuar me procedurat më transparente e profesionale një ekip të ri të shërbimit publik ndaj qytetarëve, ekipin e shkëlqyer të ndërmjetësve.

Kjo reformë e prezantuar sot, është pjesë e reformës rregullatore të Qeverisë Shqiptare, ku çdo individ ka të drejtë të çertifikohet dhe licencohet bazuar në meritat personale dhe profesionale të vërtetuara me të dhëna bindëse dhe të verifikuara ligjërisht, shkronjë më shkronjë e paragraf më paragraf nga një juri me ekspertizë të lartë, ndër më të mirat në vend, me qëllim garantimin e promovimit të profesionistëve të mirëformuar. Gjej rastin të falënderoj për punën profesionale dhe të shkëlqyer të gjithë anëtarët e Komisionit

Sot jemi dëshmitarë se historia e Institutit të vërtetë të ndërmjetësimit fillon këtu, me ju në krye dhe më të tjerë ndërmjetës që do të licencohen në ditët në vijim duke u përpjekur bashkërisht të krijojmë një histori suksesi sikurse kemi bërë edhe me operatorët e tjerë të sistemit të drejtësisë. Në përpara disa ditësh kemi çertifikuar grupin e dytë të përmbauesve gjyqësorë privatë, eksperiencën e deritanishme e të cilëve është shfaqur si një model suksesi dhe efektiv në realizimin e shërbimit për qytetarët. Qytetarët, të cilët ju ndërmjetësa, me profesionalizmin tuaj dhe me plotfuqinë që ju ka dhënë legjislacioni në fuqi, do t'i garantoni të drejtën për t'u shprehur, dëgjuar dhe vendosur mbi fatet e tij, duke i siguruar mbrojtje efektive, të shpejtë dhe pa kosto, të të drejtave që ai pretendon se i janë shkelur nga pala tjetër. Me profesionalizmin tuaj

ju duhet t'i siguron i atij, paanshmëri, përgjegjshmëri dhe konfidencialitetin e kërkuar për të realizuar një proces ndërmjetësimi efektiv dhe të suksesshëm.

Nga sot në Shqipëri, po implementojmë një model të ri të dhënies së drejtësisë në vend, si një model alternativ për qytetarët. Aktorë të këtij modeli do të jeni ju 50 persona fizik si ndërmjetës dhe një person juridik me 21 ndërmjetës. Do te jeni ju aktorët e këtij modeli, duke patur në dore fatin e kësaj reforme. Unë jam i bindur se me profesionalizmin, ndershmërinë, përkushtimin do dini ta bëni edhe në Shqipëri këtë model, një model suksesi.

Ky nuk është çelësi i artë për të zgjidhur problemet e drejtësisë shqiptare. Jo. E di shumë mirë këtë. Reforma në drejtësi është proces kompleks dhe i vështirë. Por ne po ecim, ashtu siç u kemi premtuar qytetarëve, me profesionalizëm, modesti por me vendosmëri të plotë dhe me mbështetje maksimale nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Rruga është e vështirë, por ne po ecim me vendosmëri në rrugën e reformave, dhe lumturohemi e krenohemi me të drejtë me stafin kur në këtë rrugë të vështirë, lejmë gjurmë. Gjurmë të rëndësishme për qeverisjen e mirë dhe për në drejtësi të mirë. Është hap i rëndësishëm në reformën në drejtësi, reformimi total i sistemit të noterisë dhe krijimi i OSSH për noterët, i cili ka filluar pak ditë më parë në Tiranë. Është hap i rëndësishëm në reformën në Drejtësi, reformimi tërësor i shërbimit të përmbartimit, dhe është një histori suksesi. Është gjurmë e rëndësishme, reformë e digitalizimit të sistemit të drejtësisë, portalin kryesor të gjykatave do ta inaugurojmë pas disa javësh. Është gjurmë e rëndësishme, digitalizimi i seancave audio-rekording, që kemi filluar të instalojmë. Portali i ankimeve online dhe inspektimeve online të gjykatave, padyshim janë hapa të sigurt drejtë një reforme të rëndësishme. Reforma me gjykatat administrative dhe reforma në Gjykatën e Lartë, janë padyshim po hapa të rëndësishme në reformën në drejtësi. Edhe kjo reformë e implementuar sot në Shqipëri, e plotësuar me një kuadër nënligjor tërësisht bashkëkohor të përputhshëm plotësisht me direktivat më të fundit të Bashkimit Europian dhe me modelet më të suksesshme të vendeve evropiane, të hartuara nën asistencën e shkëlqyer të ekspertëve të Misionit EURALIUS dhe përbën një hap të rëndësishëm.

Të gjitha këto, janë hapa konkrete, të dukshme, të matshme për publikun, në një reformë kaq shumë komplekse si ajo e drejtësisë. Por ne po ecim dhe po shënojmë rekorde konkrete në gjithë këtë udhërrëfyes dhe për këtë kemi të drejtë të krenohemi se reformat po kryhen dhe aktorët po lëvizin.

Por reformat, nuk mund të bëhen pa bashkëpunëtorë të shkëlqyer si ata që kam sot këtu prezent, të cilët dua t'i falënderoj për realizimin e këtij projekti madhor, USAID-in, Euralius-in, bashkëpunëtorët e mi të ngushtë, dhe padyshim ju 71 ndërmjetësit e parë, të cilëve dua t'ju garantoj se Ministria e Drejtësisë dhe partnerët e saj do t'i keni përkrah në rrugën tuaj drejt finalizimit të një modeli suksesi në Shqipëri.

**Suksese të gjithëve!**

**Ju faleminderit!**